



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:201863  
Datë: 26.06.2024  
Numri i dokumentit: 05859844

AA.nr.560/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët; Hajriz Hoti kryetar, Ramiz Kuqi dhe Mehmet Ndrecaj anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit-propozuesesit, Zyra Përmbarimore Mulhaxha Sh.P.K, me seli në Prishtinë, të cilin me autorizim e përfaqësojnë, Arianit Koci dhe Granit Vokshi, që dy avokat nga Prishtina, kundër të paditurës, Ministria e Drejtësisë me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit, me kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit-propozuesit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, nën shenjë A.nr.1176/2024, të datës;02.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë;24.06.2024, merr këtë,

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit-propozuesesit, Zyra Përmbarimore Mulhaxha Sh.P.K, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1176/2024, i datës;02.04.2024, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1176/2024, të datës;02.04.2024, është vendosur, “REFUZOHET, si i pabazuar, propozimi i paditësit-propozuesit Zyra Përmbarimore Mulhaxha SHPK, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të të paditurës Ministria e Drejtësisë me nr.178/2023, i datës 19.09.2023.”

Kundër këtij aktvendimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë paditësi, përmes të autorizuarve të tij, Arianit Koci dhe Granit Vokshi, që të dy avokat nga Prishtina, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar të gjendjes, me propozim që të aprovohet ankesa e paditësit, të prishet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1176/2024, të datës;02.04.2024, dhe të aprovohet kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit nr.178/2023 i datës;19.09.2023 i Ministrisë së Drejtësisë.

Përgjigje në ankesë nuk ka ushtruar pala e paditur.

Kolegji i apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 194, 195, 200, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, vëren se ankesa e paditësit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datë;22.09.2023, ka ushtruar padi kundër vendimit të paditurës, Ministria e Drejtësisë, me propozim për shtyrjen ekzekutimit të tij.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurës, e duke u bazuar edhe në provat dhe dokumentet e bashkangjitura në padi, propozimin e paditësit e refuzon si të pa bazuar me arsyetim se *“Kështu për të vlerësuar propozimin e paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, gjykata i’u referua nenit 22 par. 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ku përcaktohet se “me kërkesën e paditësit, organi, akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t’i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t’i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar”*. Ndërsa me paragrafin 6 të të njëjtit nen përcaktohet se *“paditësi mund të kërkoj edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit, deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni”*. Gjykata, duke vlerësuar propozimin e paditësit dhe marr për bazë dispozitat ligjore si më lartë vëren se pretendimet e paditësit lidhur me dëmin material të riparueshëm që mund ti shkaktohet paditësit janë pretendime të paqëndrueshme, pasi që një dëmi i tillë, përkatësisht dëmi material, nuk paraqet dëm vështir të riparueshëm, ngase i njëjti mund të realizohet në procedura gjyqësore lidhur me kompensimin e dëmit. Po ashtu gjykata vlerëson se pretendimet e paditësit lidhur me dëmin material nuk lidhen me ekzekutimin e vendimit të kontestuar, por ato mund të jenë rezultat i vendimit nr.54/2023 të datës 28.02.2023 për pushimin e ushtrimit të funksionit të përmbaruesit privat, kjo pasi që me vendimin e kontestuar nuk i mundësohet paditësit ushtrimi i funksionit të përmbaruesit privat, por me të njëjtin vetëm se është përcaktuar komisioni dhe rregullat procedurale për transferimin e lëndëve. Po ashtu pretendimet paditësit në drejtim të asaj se shtyrja e ekzekutimit të vendimit është në interesin e publikut, gjykata i refuzoi si të paqëndrueshme dhe të pabazuara, këtë për faktin se me shtyrjen e ekzekutimit të vendimit në fjalë do të dëmtoheshin pikërisht palët e përfshira në lëndët përmbarimore, e të cilat lëndë sipas vendimit në fjalë do të duhej të barten te përmbaruesit e tjerë privat, e të cilat do të mbeteshin në zyrën e paditësit përderisa i njëjti vazhdon të jetë pushuar nga funksioni i përmbaruesit privat. Pra për pasojë palët do të dëmtoheshin, pasi që lëndët e tyre nuk do të përfundonin me kohë. Gjithashtu është refuzuar edhe pretendimi i paditësit sipas të cilit shtyrja e ekzekutimit nuk është në dëm të palës kundërshtare –të paditurës MD, pasi që sipas tij nuk ka asnjë provë argument apo indikacion çfarëdo qoftë se të njëjtës i shkaktohet ndonjë. Ky refuzim ka ndodhur sepse një arsyetimi i tillë nuk paraqet bazë të mjaftueshme për aprovimin e tij si të bazuar. Prandaj nga e gjithë kjo, gjykata vlerësoi se nuk janë plotësuar kushte ligjor si të përcaktuara me dispozitën e nenin 22 paragrafi 2 të LKA, kushte këto të cilat duhet të provohen nga paditësi, për të shtyrë pastaj gjykata ekzekutimin e vendimit të goditur me padi. Paditësi në propozimin për shtyrjen e ekzekutimit nuk ka dhënë fakte për të mbështetur atë, respektivisht nuk ka ofruar prova të mjaftueshme për të vërtetuar plotësimin e kushteve të parapara me nenin 22 paragrafi 2 të LKA, por paditësi kryesisht është mbështetur në prova dhe fakte që nuk përbëjnë ndikim për vlerësimin e bazueshmërisë së kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit.”

Kolegji i Gjykatës së Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m), e rrjedhimisht edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, ngase edhe sipas vlerësimit të kolegjit të apelit, në rastin konkret nuk janë plotësuar në mënyrë komulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të përcaktuara me nenin 22 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, dhe duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm një përfundim të tillë të Gjykatës së shkallës së parë.

Me nenin 22 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative është përcaktuar se shtyrja e ekzekutimit të vendimit mund të bëhet, nëse ekzekutimi i aktit administrativ do ti sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar. Në rastin konkret paditësi me ankesën e ushtruar kërkon shtyrjen e ekzekutimit të vendimit me arsyetim se *“Paditësit do t’i shkaktohet dëm vështirë i riparueshëm me mos shtyrjen e ekzekutimit të këtij vendimi të kontestuar, paditësi është në mëshirën e Ministrisë së Drejtësisë ashtu që të gjitha lëndët përmbartimore do t’i merren paditësit di t’i barten ndonjë përmbartuesi tjetër. Në këtë mënyrë paditësit nuk ka asnjë mundësi për kthimit e këtyre lëndëve edhe nëse anulohet vendimi kontestues. Prandaj si pasojë e bartjes së lëndëve si dhe si pasojë e mos ushtrimit të kësaj veprimtarie paditësi pëson dëm për shkak të pamundësisë së realizimit të të ardhurave për këtë veprimtari...”*

Duke i marrë parasysh këto pretendime ankimore të paditësit në ankesë të cekura më lartë ndaj aktvendimit të Gjykatës së shkallës së parë, kolegji i apelit vlerëson se të njëjtat janë të pa bazuara dhe të pa argumentuara me prova konkrete për tu aprovuar ankesa dhe për tu lejuar shtyrja e ekzekutimit të vendimit të kontestuar deri në vendosjen sipas padisë së paditësit.

Ngase edhe vlerësimi i kolegjit të apelit është se paditësi-propozuesi nuk ka ofruar prova për të vërtetuar plotësimin e tre kushteve të parapara në mënyrë komulative për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar, siç përcaktohet me nenin 22 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Kjo për faktin se kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kryesisht është e mbështetur në fakte dhe prova që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, përkatësisht objektin e kërkesëpadisë së paditësit, për të cilat Gjykata do të vendosë në mënyrë meritore pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të padisë për anulimin e vendimit të kontestuar, por të cilat tani nuk janë me ndikim për vlerësimin e besueshmërisë së kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit. Prandaj, nëse Gjykata në rastin e vendosjes sipas padisë së paditësit, gjen se vendimi e të paditurës është i paligjshëm, atëherë çfarëdo dëmi eventuale i shkakuar ndaj paditësit mund të llogaritet dhe mund të kompensohet.

Prandaj, mbi këtë gjendje të fakteve kolegji i apelit vëren se Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit-propozuesit me rastin e refuzimit të kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar.

Në këtë kuptim, bazuar në arsyet e dhëna më lart, kolegji i apelit vlerëson se aktvendimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktvendimit është i kuptueshëm, nuk është në

kundërthënie me vetveten ose me arsyet e aktvendimit, dhe se aktvendimi përmban arsye të mjaftueshme dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe kolegji i apelit, dhe nga këto arsye ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i goditur me ankesë vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga arsyet e dhëna më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 208 dhe nenin 209 pika b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
AA.nr.560/2024, datë:24.06.2024

Kryetari i kolegjit  
Hajriz Hoti